



# Letër standarde për tenderuesin e eliminuar

*Në përputhje me Rregullat e Prokurimit në BQK, respektivisht sipas Nenit 33 të këtyre Rregullave*

*Datë: 12 korrik 2013*

*Nga: Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, BQK*

*Për: N.Z.B. "Bashkimi" Prishtinë*

**Titulli: "Ekzekutimi i punëve të projektit për rimodelimin e zyrave"**

**Nr. i Prokurimit: BQK 13 034 321**

I/E nderuar,

Fillimisht, ju faleminderit që morët pjesë në tenderin tonë të lartpërmendur.

Sic jeni në dijeni, procedura e këtij tenderi është udhëhequr në pajtim me Rregullat e Prokurimit në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (në dispozicion në [www.bqk-kos.org](http://www.bqk-kos.org)).

Kompania e juaj ishte shpallur fituese e këtij tenderi me njoftimin e shpallur nga ana jonë për dhënien e kontratës më datë 5 qershor 2013. Më datë 12 korrik 2013, ne pranuan me shkrim konfirmimin nga ana e juaj se kompania e juaj tërhiqet nga ekzekutimi i kontratës. Arsyeja e dhënë nga ana juaj për tërheqje nga ekzekutimi i kontratës ishte angazhimi i kompanisë tuaj në projekte tjera.

Mbi këtë bazë, BQK-ja mori vendim që kompania e juaj të shpallet e eliminuar nga realizimi i kontratës në fjalë.

Ju, si tenderues, keni të drejtë të parashtroni ankesë pranë Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, në një afat prej 5 ditësh kalendarikë nga data e marrjes së këtij njoftimi.

Ju faleminderit për mirëkuptim.

Me respekt,  
Divizioni i Prokurimit